REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Nr. 9295

AKT-MIRATIMI

ORGAN I MIRATUAR

I VLERËSIMIT TË KONFORMITETIT

Mbështetur në Kreun V, të ligjit Nr. 10489, datë15.12.2011 "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen etregut të produkteve jo ushqimore" i ndryshuar, Urdhrin e Ministrit Nr. 53 datë 05.10.2017 "Për miratimin e rregullores "Për procedurat e miratimit dhe mbikëqyrjes së organeve evropiane të notifikuara dhe organeve të miratuara të vlerësimit të konformitetit", si dhe në Çertifikatën e Akreditimit me Nr. TI 036 regjistrimi, Çertifikatën e Akreditimit me Nr. CN 011 regjistrimi, Çertifikatën e Akreditimit sistemi ESYD me nr. 591-11, anekset C/22 dhe C/25,

M I R A T O J:

Subjektin:	**"SWISS APPROVAL ALBANIA SHPK sh.p.k.**
Me Administrator:	Arben Dhima
Me Drejtues Teknik	Orges Mara, Marjus Filipi, Dorian Osmani.
Adresa e subjektit:	Rruga "Sami Frashëri", Ndërtesa Nr. 19, Hyrja Nr.8, 1019, Tiranë.
Tel.:	355 443 9515/ 355 697073004;
E-mail:	info@swissapproval.al; adhima@swissapproval.al

të ushtrojë veprimtarinë si "Organ i Miratuar i Vlerësimit të Konformitetit dhe Organizëm që operon në fushën e Çertifikimit të Personelit", sipas akreditimit.

Tipi i OMVK	Trupë Inspektuese e tipit A Organizëm Çertifikues Personeli
Fusha e Inspektimit:	**I. Vlerësim konformiteti bazuar në Çertifikatën e Akreditimit nr: TI 036:** A. Vlerësim konformiteti në fushën e enëve nën presion: 1. Inspektimi i Pajisjeve nën presion: - Pajisjet nën presion stacionare. - Tubacionet nën presion (lidhjet teknologjike brenda objektit) - Aksesorët e sigurisë dhe aksesorët nën presion. 2. Inspektimi i kaldajave me avull dhe ujë të nxehtë.

3. Inspektimi i rezervuarëve të gazit të lëngëzuar të naftës (GLN-së) me kapacitet me të vogël ose të barabartë me $13m^3$.
4. Inspektimi i rezervuarëve të gazit të lëngëzuar të naftës (GLN-së) me kapacitet me të madh ose të barabartë me $13m^3$.
5. Inspektimi i enëve nën presion kriogjenike të term izoluara me vakum.
6. Inspektim i rezervuarëve mbitokësor të depozitave të hidrokarbureve të lëngët.
7. Inspektim i çisternave automobilistike për transport të mallrave të rrezikshëm.
   - Klasa 2: gaze.
   - Klasa 3: lëngje të djegshme.
8. Inspektim i kokave të pusit.
9. Inspektim i bombolave të mbushura me GLN.
10. Inspektim i automjeteve që transportojnë bombola te mbushura me GLN.

B. Vlerësim konformiteti në fushën elektrike:

1. Inspektim i instalimeve elektrike në ambiente të zakonshme.
2. Inspektim i instalimeve elektrike në ambiente me rrezik zjarri dhe/ose në zona potencialisht shpërthyese (ATEX).
3. Inspektimi i impianteve të mbrojtjes nga shkarkimet atmosferike (rrufeja).
4. Inspektimi i kabinave elektrike TM/TU.
5. Inspektimi i linjave ajrore TU dhe TL.
6. Inspektimi i linjave kabllore.
7. Inspektimi i impianteve shpërndarës TL dhe nënstacioneve (impiantet shpërndarës nën 1000V, mbi 1000V dhe nënstacionet elektrike).
8. Inspektimi i fushës elektromagnetike për pajisjet dhe instalimet elektrike.

C. Vlerësim konformiteti në fushën mekanike:

1. Inspektim i makinerive ngritëse:
   - Vinçat lëvizës.
   - Vinçat kullë.
   - Vinça urë dhe me këmbalec.
   - Makineritë ngritëse.
2. Inspektim i setit ngritës dhe kontejnerëve për transport mallrash apo shërbimesh nëpërmjet detit.

II. Vlerësim konformiteti për inpektimet bazuar në Çertifikatën e Akreditimit sistemi ESYD me nr. 591-11, anekset C/22 dhe C/25, për:

1. Inspektim të pajisjeve ngritëse:
   - Vinça të cilët janë në funksion pranë detit (vinça në ndërtimin e anijeve, vinça për shërbime portuale etj.)
   - Vinçat e përdorur në industritë e çelikut, fonderite ose fabrikat e tjera ku transportohen materiale të rrezikshme, të barabartë ose më shumë se 2 ton.

- Vinçat e përdorur në industritë e çelikut, shkritoret ose fabrikat e tjera ku transportohen materiale të rrezikshme (të tilla si lëndët djegëse shpërthyese), të barabartë ose më shumë se 2 ton.
- Vinçat e urës me kapacitet ngritës të barabartë ose më shumë se 5 ton.
- Vinçat e urës me kapacitet ngritës më të vogël se 5 ton.
- Vinça kullë për ndërtesa.
- Vinça të vegjël për ndërtime deri në 250 kg.
- Platformat e ngritjes së automjeteve mbi 4 ton.
- Vinça fikse me krah dhe vinça fikse me shtyllë me kapacitet ngritës më shumë se 2 ton.
- Vinça fikse me krah dhe vinça fikse me shtyllë, me kapacitet ngritës më pak se 2 ton.
- Pajisje për ngritjen e personave që kanë rrezik renieje nga një lartësi vertikale më shumë se 3 m.
- Makineri ngritëse si vinça të lëvizshëm, vinça të lëvizshëm të shportës, vinça- ekskavator, vinça urë.
- Platforma ngritëse për pajisje shtëpiake, pajisje ngritëse për aeroplan.
- Pajisje për ngriten e personave me aftësi të kufizuara në aeroplan, ashensorët e lëvizshëm të platformave të punës.
- Pompë betoni.
- Pirunët ngritës (ashensorë).
- Platformat e ngritjes së mjeteve deri në 4 m.
- Vinça për grumbullimin e automjeteve.
- Vinça ngritës të kontrolluar me dorë më shumë se 100 kg.
- Platforma të qëndrueshme ngritëse.
- Pajisje hidraulike për platforma gërshërësh me kapacitet ngritje më shumë se 200 kg.

3. Kaldaja me avull (tubacionet).
4. Konstruksioni metalik. Ekzekutimi i konstruksioneve prej çeliku.
5. Konstruksioni metalik. Mbrojtja nga korrozioni i strukturave të çelikut nga sistemet mbrojtëse të bojës.
6. Konstruksioni metalik. Përgatitja e siperfaqeve të çelikut para aplikimit të bojrave dhe produkteve të ngjashme.
7. Produkte metalike. Artikuj të galvanizuar të zhytur në shkrirje.
8. Litarë celiku.
9. Tuba e tubacione.
10. Tubacione transporti.
11. Tuba e tubacione transporti – Veshje kundër korrozionit.
12. Tuba e tubacione transporti – Mbrojtja katodike.
13. Asamblime depozitash.
14. Tuba metalikë.
15. Saldime.
16. Rezultatet e provave pa-shkatërrim:
    - Zbulimi i papërsosmërive të sipërfaqes me metodën e depërtimit të lëngshëm (PT);
    - Zbulimi i papërsosmërive sipërfaqësore dhe nën sipërfaqe me metodën e grimcave magnetike (MT);
    - Inspektimi vizual i saldimit (VT);
    - Inspektimi i papërsosmërive të brendshme me metodën ultrasonike (UT/W);

- Matja e trashësisë së pllakave me metodën ultrasonike (UT/T);
- Zbulimi i papërsosmërive të brendshme me metodën radiografike industriale (RT);
- Zbulimi i papërsosmërive të brendshme me metodën automatike ultrasonike me sonda konvencionale (AUT);
- Zbulimi i papërsosmërive të brendshme me metodën automatike ultrasonike duke përdorur Phased Array (PAUT);
- Zbulimi i papërsosmërive të brendshme me metodën automatike ultrasonike Time of Flight Diffraction (TOFD);

17. Inspektimi i enëve nën presion:
    a) Enët nën presion me kapacitet më të madh se 450 lt.
    b) Enët me gaz të lëngëzuar të naftës (LPG).
    c) Enë të thjeshta nën presion.
    d) Bashkime të përhershme për pajisjet nën presion si:
        - Enë nën presion që nuk i nënshtrohen flakës ose ngrohjes tjetër hyrëse që krijon rrezik mbinxehjeje;
        - Enë metalike që përmbajnë lëngje ose gaze, gaze të lëngëzuara ose të tretura, me presion maksimal pune mbi 16 bar;
        - Enë metalike që përmbajnë lëngje ose gaze, gaze të lëngëzuara ose të tretura, me presion maksimal pune deri në 16 bar;
        - Enë plastike;
        - Enë nën presion që i nënshtrohen flakës ose ngrohjes tjetër hyrëse që krijon rrezik mbinxehjeje, të destinuara për prodhimin e avullit ose mbinxehjen e ujit në temperaturë mbi 110°C dhe me vëllim mbi 2 litra;
        - Kaldaja me trup cilindrik;
        - Kaldaja me tuba uji;
        - Tubacione;
        - Tubacione metalike që përmbajnë lëngje ose gaze, gaze të lëngëzuara ose të tretura, me presion maksimal pune mbi 16 bar;
        - Tubacione metalike që përmbajnë lëngje ose gaze, gaze të lëngëzuara ose të tretura, me presion maksimal pune deri në 16 bar;
        - Tubacione metalike industriale;
        - Tubacione plastike;
        - Valvula.

III. Çertifikim Personeli bazuar në Certifikatën e Akreditimit Nr. CN 011 për:

1. <u>Personat që punojnë me pajisjet/instalimet nën presion:</u>
    - Grupi A, Përdorues/operues/shfrytëzues të rezervuareve/nstalimeve të GLN-së me vëllim deri 13 m^3 mbi/nën tokë;
    - Grupi B, Përdorues/operues/shfrytëzues të rezervuarëve/instalimeve të GLN-së me vëllim mbi 13 m^3, mbi/nën tokë;
    - Grupi C, Përdorues/operues/shfrytëzues të enëve/instalimeve nën presion të pajisjeve teknologjike dhe rezervuarëve të ajrit;

- Grupi D, Përdorues/operues/shfrytëzues të kaldajave me avull dhe me ujë/vaj të nxehtë;
- Grupi E, Përdorues/operues/shfrytëzues të enëve/instalimeve nën presion kriogjenike;
- Grupi F, Përdorues/operues të instalimeve të qendrave të mbushjes dhe të makazinimit të bombolave me GLN;
- Grupi G, Përdorues/operues për shkarkimin dhe transvazimin së cisternave automobilistike/hekurudhore të GLN-së dhe mallrave të rrezikshëm.
- Grupi H, Persona që kanë për detyrë dhe përgjigjen për transportin e bombolave të GLN-së dhe instalimin e tyre tek konsumatori.

2. Personat që punojnë në impiantet, instalimet, linjat dhe pajisjet elektrike:
   - Grupi A: Personat që përdorin pajisje/impiante elektrike lidhur me sigurimin teknik elektrik të klasifikuar në Grupin I, II, III, IV dhe V;
   - Grupi B: Instalues dhe mirëmbajtës të pajisjeve, impianteve dhe instalimeve elektrike të tensionit të ulët, (ITU);Grupi C-1: Instalues të autorizuar për linjat ajrore ose nëntokësore me tension të lartë deri 30 kV (përfshirë), Tipi 1;
   - Grupi C-2: Instalues të autorizuar për linjat ajrore ose nëntokësore me tension të larte mbi 30 kV, Tipi 2;
   - Grupi D-1: Instalues të autorizuar për instalimet elektrike të tensionit të lartë me tension nominal jo me të madh se 30 kV, ATl;
   - Grupi D-2: Instalues të autorizuar për instalimet elektrike të tensionit të lartë pa kufij tensioni, AT2.

3. Personat që punojnë me vinça; makina ngritëse, transportuese dhe të punimit të tokës:
   - Grupi A-1: Operator të vinçave kullë;
   - Grupi A-2: Operator të vinçave urë;
   - Grupi A-3: Operator të vinçave të lëvizshëm;
   - Grupi B-1: Operator i makinerive ngritëse;
   - Grupi B-2: Operator i makinave transportuese të stacionuara;
   - Grupi C-1: Ekskavatorist: (për mjete me goma ose me zinxhirë);
   - Grupi C-2: Automakinist: autovinça, autobetoniere, autobetonpompa, autobitumatrine, autosonda;
   - Grupi C-3: Buldozerist, (me rrota ose me zinxhirë).

IV. Lëshimin e Vërtetimit Teknik për respektimin e normave dhe kushteve teknike në instalimet teknologjike, për subjektet që kryejnë aktivitet në fushën e prodhimit, transportimit dhe tregtimit të gazit, naftës dhe nënprodukteve të tyre.

V. Miratimin e projektit teknologjik.

VI. Miratimin e kartës teknologjike.

VII. Miratimin e projekteve për instalimet dhe linjat elektrike të tensionit të lartë, mbi 1 kv.

Ligje/Rregullat teknike/ standardet e sigurisë së produktit/pajisjes/instali mit të vënë në shërbim:	1. Ligji 10489, datë 15. 12. 2011 "Për tregtimin dhe mbikqyrjen e tregut të produkteve jo ushqimore", i ndryshuar. 2. Ligji Nr. 9272, datë 16.9.2004 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në "Marrëveshjen Europiane "Për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave të rrezikshme (ADR) dhe Protokollin e Nënshkrimit". 3. Ligji Nr.8450, datë 24.2.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar. 4. Vendim Nr. 755, datë 12.11.2014, "Për përcaktimin e procedurave e të kushteve për dhënien e licencës së përpunimit për impiantet e përpunimit të nënprodukteve të naftës". 5. Vendim nr. 19, datë 14.1.2015, (i ndryshuar) "Për procedurat dhe kushtet për dhënien, transferimin dhe përsëritjen e licencës së koncesionit për rafineri për kryerjen e veprimtarisë së përpunimit të naftës bruto për prodhimin e nënprodukteve të saj" 6. Vendim nr. 551, datë 18.6.2015, (i ndryshuar) "Për miratimin e kritereve dhe të procedurave për pajisjen me certifikatën e lejes profesionale për veprimtaritë studimoreprojektuese dhe zbatuese për kërkimin, prodhimin, përpunimin, transportimin, depozitimin dhe tregtimin e lëndëve hidrokarbure". 7. Vendim nr. 970, datë 2.12.2015, (i ndryshuar), "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj". 8. Vendim nr. 491, datë 19.7.2017, "Për përcaktimin e rregullave, të kushteve teknike dhe normave të mirëmbajtjes së instalimeve nën presion, që shërbejnë për përpunimin, transportimin, depozitimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre"; 9. Vendimi nr. 1062 datë 23. 12. 2015 "Për miratimin e rregullit teknik "Për pajisjet dhe bashkësitë nën presion". 10. Vendim Nr. 1065, datë 23.12.2015 "Për miratimin e rregullit teknik "Enët e thjeshta nën presion" dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara" 11. Urdhëri i Ministrit Nr. 184, datë 5.7.2005 "Kushtet teknike dhe normat e projektimit për impjantet dhe instalimet që shërbejnë për transportin, depozitimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre" 12. Rregullorja "Për projektimin, prodhimin, vendosjen dhe shfrytëzimin e pajisjeve nën presion" Tiranë 1984. 13. Rregullore e sigurimit teknik te kaldajave te avullit dhe ujit te nxehte" Kapitulli IV "Kontrollet Teknike" - 1988. 14. Metode jo standarde- Rregullore e shfrytëzimit të kaldajave me avull e vitit 1984. 15. Rregullorja "Për përdorimin dhe kontrollin teknik të bombolave të gazit dhe fuçive që shërbejnë për ruajtjen dhe transportimin e gazeve të lëngëzuar" Tiranë 1984. 16. Vendim nr. 1060, datë 23. 12. 2015 "Për miratimin e rregullit teknik "Për makineritë" 17. Ligji nr.32/2016, datë 15. 12. 2011 "Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve nën presion". 18. Vendim nr. 212/2016 "Për përcaktimin e kushteve dhe të rregullave teknike për përpunimin e bombolave të mbushura me gaz të lëngëzuar të naftës GLN".

	19. Vendimi nr. 1056, datë 23.12. 2015 "Për miratimin e rregullit teknik "Për sigurinë e ashensorëve në përdorim". 20. Vendimi nr. 192, datë 4.4.2018 "Për miratimin e rregullit teknik "për ashensorët dhe komponentët e sigurisë për ashensorë dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara" 21. Rregullore e pajisjeve nën presion të trajtimit të gazit të lëngëzuar të naftës (GLN). 22. Rregullore e sigurimit dhe shfrytezimit teknik per impiantet, pajisjet dhe instalimet elektike. 23. Vendim nr. 245, datë 30.3.2016 "Për miratimin e rregullit teknik "Për kërkesat teknike në instalimin dhe kontrollin e diapozitivit diferencial, vendosur në pajisjet, impiantet dhe instalimet elektrike" dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara"; 24. Urdhër Nr. 3403/1 Prot. date 30.06.2003 "Rregullore e sigurimit dhe shfrytëzimit teknik për impiantet, pajisjet dhe instalimet elektrike" 25. Ligji nr.10 469, datë 13.10.2011 "Për mbrojtjen nga rrezatimet jojonizuese". 26. Vendim nr. 743, datë 16.10.2012 "Për miratimin e rregullorës "për mbrojtjen e publikut nga rrezatimet jojonizuese në vendin e punës." 27. Vendim nr. 843, datë 3.12.2014 "Për miratimin e rregullores "për mbrojtjen e punëmarrësve nga risqet lidhur me rrezatimet jojonizuese në vendin e punës." 28. Vendim nr. 1054, datë 13.12.2015 "Për miratimin e rregullit teknik "për përputhshmerinë elektromagnetike" dhe përcaktimin e listës së standardeve të harminizuara. 29. Ligji nr. 8734, datë 01.02.2001 "Për garantimin e sigurisë se punës te pajisjeve dhe instalimeve elektrike", i ndryshuar. 30. Vendim nr. 1066 datë 23.12.2015 Për miratimin e rregullit teknik "Për pajisjet dhe sistemet mbrojtëse për përdorim në ambiente (atmosferë) potencialisht shpërthyese" dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara 31. Ligj nr. 61/2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 43/2015, "për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar neni 7,8 32. Ligj nr. 10 237, datë 18.2.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë. 33. Vendim nr. 482, datë 17.6.2020 "Për miratimin e rregullës teknike "Për kushtet teknike dhe garantimin e sigurisë së linjave elektrike me tension lartë mbi 1 kv". 34. Vendim nr. 483, datë 17.6.2020 Për miratimin e rregullës teknike "Për kushtet teknike dhe garantimin e sigurisë së instalimeve elektrike me tension lartë mbi 1 kv". 35. Ligji nr. 13/2013, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 8734, datë 01.02.2001, "Per garantimin e sigurisë së punës së pajisjeve dhe instalimeve elektrike", i ndryshuar, 36. Ligji nr.9148, date 30.10.2003 "Për ratifikimin e Protokollit të vitit 2002 të Konventës nr.155 të Organizatës Ndërkombëtare të Punës për "Sigurinë në punë, shëndetin dhe ambjentin e punës".
Periudha e vlefshmërisë:	Pikat I, II, IV, V,VI,VII - deri 05.11.2030 Pika III- deri 10.11.2028

Territori i ushtrimit të veprimtarisë:	Në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
Personi përgjegjës;	Arben Dhima, Orges Mara, Marjus Filipi, Dorian Osmani.
E-mail:	adhima@swissapproval.al
OMVK regjistrohet me Nr. Identifikimi:	**OMI 011 Rishikim 5**

OMVK detyrohet të plotësojë gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, kërkesat dhe kushtet sa më poshtë:

1. Është përgjegjës për veprimtaritë e vlerësimit të konformitetit, të kryera sipas objektit dhe afatit të këtij miratimi dhe çdo veprimtari tjetër të kryer, përfshirë veprimtaritë nënkontraktuese.
2. Nuk duhet të përfshihet në veprimtaritë që mund të krijojnë konflikt me pavarësinë/paanësinë e tij të gjykimit ose integritetin për aktivitetet e vlerësimit të konformitetit, për të cilat ai është miratuar;
3. Siguron se veprimtaritë e degëve ose nënkontraktorëve të tij nuk prekin/ndikojnë në konfidencialitetin, objektivitetin, paanësinë e veprimtarive të tij të vlerësimit të konformitetit;
4. Detyrohet të informojë Ministrin për çdo rast, në të cilin ky organ bëhet i paaftë të sigurojë përmbushjen e kushteve të vendosura për ushtrimin e miratimit të vlefshmërisë së konformitetit;
5. Informon Ministrin për çdo kërkesë për informacion, të cilën ai ka marrë nga Inspektorati Shtetëror në vartësi të MIE-s për veprimtarinë e vlerësimit të konformitetit;
6. Detyrohet të mbajë regjistra të plotësuar rregullisht të të gjitha proçedurave të vlerësimit të konformitetit, për të cilat ai është miratuar dhe të rezultateve të tyre për jo me pak se 10 vjet.
7. Me kërkesë të Ministrit përgjegjës detyrohet të marrë pjesë në testime ose krahasime të tjera të përcaktuara për OMVK-të.
8. Në fund të çdo periudhe katërmujore, detyrohet ti dërgojë Ministrit (SAP) regjistrin e inspektimeve, ose çertifikatave (sipas formateve të miratuara), të lëshuara për periudhën në fjalë.
9. Organi i Miratuar detyrohet t'u krijojë akses të plotë punonjësve të SAP, të pajisur me urdhër të Ministrit, të hyjnë në të gjitha ambjentet ku ka kryer vlerësim të konformitetit të përcaktuar në miratimin e lëshuar, në rastet e kërkesës për evidentim të të dhënave për përmbushjen e kritereve të vlerësimit të konformitetit;

Në rast të konstatimit të mos plotësimit të kërkesave dhe kushteve sipas pikave më sipër, ose në rast se organi i miratuar nuk arrin të përmbushë me një apo disa kritere a kërkesa, të përcaktuara në rregullat teknike përkatëse apo në rregullat për sigurinë e produktit/instalimit të vendosur në shërbim përdorim dhe kushtet e përcaktuara në aktin e miratimit, SAP i propozon Ministrit pezullimin e Aktit të Miratimit, deri në afatin e dhënë për plotësimin e tyre. Nëse Organi i Miratuar dështon në plotësimin e kushteve dhe kërkesave sa më sipër brenda afatit të caktuar, SAP përgatit dhe i paraqet për firmë Ministrit, urdhërin për shfuqizimin e Aktit të Miratimit dhe heqjen e emrit të OMVK nga regjistri i organeve të miratuara.

Datë: 13/ 11 /2026

MINISTËR
Enea KARAKAÇI

Me autorizim
ZËVENDËSMINISTRI

Erlind SULO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË - TIRANË